

Kuriozitete mbi egzemplar të vjetër ulliri

Ndër veçoritë dalluese të ullinjëve të vjetër shekullorë është edhe cilësia e “luksit që gëzojnë” në pamjen e jashtëme, ku përngjasimi me diçka, i bën ata mjaft tërheqës sidomos në trendin e ditëve të sotme në zhvillimin e agroturizmit. Interesant dhe i tillë duket edhe rasti i këtij egzemplari të vjetër ulliri, eksploruar nga specialistë të IRGJB-s, në zonën e Gërdecit në komunën Prezë, Tiranë. Egzemplari njihet në zonë, ulliri si “fytyrë njeriu”.



Një tjetër kuriozitet i familjeve të vjetra shqiptare, ku bimën e ullirit e lidhnin ngushtë me kulturën dhe traditën e kohës, ishte jo vetëm mbjellja e tyre në pronat e familjeve të fisme apo me traditë, në zonë, por në disa raste referohet se edhe varret e njerëzve të parë të fisit vendoseshin pranë ullinjve shekullorë. I tillë është edhe rasti në zonën midis komunës Bupq dhe Prezë, ku te një egzeplar i vjetër ulliri, të familje së Bojve në Prezë, familjarët kanë vendosur varrin e stërgjyshit të familjes. Siç shihet edhe në foto, në bazën e trungut të pemës sipas familjarëve, egziston një varr që ndan pemën në dy degëzime.



Prof.As. Adriatik Çakalli